



Një fakt të tillë e bën publik kryetari i komunës Postrisë, Faz Shabaj. Fillimi i stinës së shirave dhe shtimi i prurjeve të lumit Kir, ka bërë që rreziku i gërryerjes së një pjese të mirë të këtij aksi, edhe pse ndodhet rreth 70 m mbi shtratin e lumit, të jetë real. Në këtë aks rrugor kanë filluar të evidentohen shembjet dhe plasaritjet e para nga gërryerja që lumi Kir po i bën pjesës së poshtme të rrugës. Sipas Shabajt, lumi, nga viti në vit sa vjen e gërryen pjesët anësore të argjinaturës së tij, duke dëmtuar në maksimum shtratin e rrugës që kalon në këtë komunë. Sipas specialistëve të Këshillit të Qarkut Shkodër, parashikohet të ndërhyhet në mënyrë urgjente për ndërtimin e një argjinature rreth 200 m të gjatë dhe 10 m lartësi. Pas hartimit të projektit, problemi qëndron në mbështetjen financiare të tij. “Për momentin është biseduar me përfaqësues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të cilët na kanë premtuar që ta realizojnë një gjë të tillë me këtë shumë. Ndaj dhe ne jemi në fazën e pritjes”, ka pohuar më tej Shabaj. Ai thotë se, në rast se këtë prag vjeshte nuk fillon puna për ndërtimin e argjinaturës, atëherë jo vetëm që vlera financiare do të rritet edhe më shumë, por 4 komuna të zonave të thella malore të Dukagjinit do të mbesin të izoluara nga zona e Shkodrës dhe më gjerë, pasi aksi rrugor do të jetë jashtë funksionit. Krahas amortizimit të tejskajshëm të rrugës automobilistike që lidh komunat e Dukagjinit me Shkodrën, (kujtojmë këtu numrin e madh të aksidenteve rrugore me numër të konsiderueshëm viktimash), tashmë ky aks po përballet edhe me një fenomen tjetër: atë të gërryerjes së pjesës së poshtme të shtratit të rrugës. Për pasojë, rruga që lidh rajonin e Shkodrës me komunat e Postrisë, Shllakut, Temalit dhe Pultit, të mbesin të izoluara.